

VENDIM
Nr. 394, datë 20.6.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR AVOKATIN E
POPULLIT, PËR FINANCIMIN E KONFERENCËS SË OMBUDSMANËVE TË VENDEVE
FRËNGJISHTFOLËSE, QË ZHVILLOHET NË TIRANË, NË TETOR 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Avokatit të Popullit, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi 20 000 (njëzet mijë) euro, për financimin e Konferencës së Ombudsmanëve të vendeve frëngjishtfolëse, që zhvillohet në Tiranë në tetor të vitit 2012.

2. Ky fond të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë, të datës kur do të bëhen pagesat dhe i transferohet Avokatit të Popullit.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Avokati i Popullit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha